



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Doretuar Punëno/Prodato Received/Delivered	26.12.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitja Quantity
SKIMSHICK	7665/2023		1/7



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1364/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Sabile Avdyli-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1364/2023, të datës 01.11.2023, të parashtruar nga ankuesit _____, kundër Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Kosovës Nr.23/165, të datës 12.10.2023, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1364/2023, e datës 01.11.2023, e parashtruar nga ankuesit _____
- II. Obligohet Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet** më Rëndësi Strategjike, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të kualifikoj në kuadër të listës së sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimeve me rëndësi strategjike, sistemin e teknologjisë informative dhe të komunikimit të menaxhuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe së ankuesit si në pikën I të dispozitivit, të përfshihen në listën e eksperteve dhe atë ankuesi Sami Sami Zeka, në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative, Ekspert 3, Klasa B3; ankuesi _____, në pozitën e punës Administrator i bazave së të dhënave dhe sistemeve, Ekspert 6, Klasa B6, ndërsa, ankuesi _____ në pozitën e punës Zyrtarë të IT-së/ekspertë të Teknologjisë Informative, Ekspert 7, Klasa B7, si dhe të ndërmarr të gjitha veprimet tjera ligjore në pajtim me rregulloren përkatëse për ekspertë.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesit _____ të cilët me autorizim të përbashkët i përfaqëson _____, (me tej referuar ankuesit), më datë 01.11.2023, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e regjistruar nën shenjën A.nr.1364/2023, kundër Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Kosovës, lidhur me aprovimin e listës së eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej vetëm Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 01.12.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, ndërsa, ky i fundit, me datë 18.12.2023, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6799/2023 të datës 01.11.2023 të parashtruar nga ankuesit, Autorizimin e datës 01.11.2023, për emërim të autorizuesit të përbashkët S. _____; Vendimin e datës 12.10.2023 me Nr. 23/165 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Raportin punës se Komisionit për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rendësi strategjike; Vendimi i Autoritetit Kombëtar i Kualifikimeve me Nr. 01/38 të datës 22.02.2022; Vendimin me numër 01/233, të datës 07.06.2023; Listë Distribuimi e datës 16.03.2023, Pyetësor për identifikimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rendësi strategjike të AKSP-së; Kërkesë përgjigje në ankesë të datës 01.12.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 11.12.202, Kërkesën e KPSHCK-së të datës 18.12.2023 për AKSP-në, email-përgjigje në kërkesën e KPMSHC të datës 18.12.2023; Akt emërimin e ankuesit B.B më numër të protokollit 114/1 të datës 06. 05.2011, përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Specialist i Teknologjisë Informative; Akt emërimin e ankuesit E.S, më numër të protokollit 115/5 të datës 06.09.2011; Akt emërimin e ankuesit M.M, më numër të protokollit 128, të datës 08.10.2013; përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Administrator i Bazave të të dhënave dhe Sistemeve, Akt emërimin e ankuesit S.Z, me numër protokollit 103 të datës 01.08.2013, përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative; procesverbal i Komisionit të datës 03.05.2023 së bashku me listën në exel fq 1/6; lidhur me vlerësimin e sistemit të TIK të ASKP-së, si dhe Vendimin nr. 07/132 të datës 08.03.2023, i Qeverisë së Kosovës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueseve është e bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesit janë të punësuar në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe atë: _____, në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative, _____ në pozitën e punës Administrator i bazave të të dhënave dhe

sistemeve, ndërsa ankuesit dhe) pozitën e punës Zyrtarë të IT-së-
ekspertë të Teknologjisë Informatike në Divizionin e IT-së.

Tutje nga shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur së Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr.07/132 të datës 08.03.2023, ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave të dërguara nga institucionet që kanë të bëjnë me sistemin shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike sipas Rregullores Nr.11/2023 për Ekspertët dhe dërgimin në Qeveri, të listës së Eksperteve, të kategorizuar në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, ka përgatit Raportin e punës, listën e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimeve me rëndësi strategjike dhe listën e pozitave të eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, të cilat janë miratuar nga Qeveria e Kosovës, me Vendimin nr.23/165 të datës 12.10.2023, i kundërshtuar më ankesë.

Duke qenë së Sistemi i Teknologjisë Informatike të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (me tej AKSP), nuk është përfshirë nga Komisioni gjegjës në listën e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, e në këtë mënyrë asnjë nga zyrtaret e Divizionit të IT-së të këtij institucioni nuk është përfshirë në listën e eksperteve sipas shtojcës 14.4 të ligjit për paga në sektorin publik, ankuesit parashirojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Kosovës, lidhur me aprovimin e listës së eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Pretendojnë së Agjencia e Kosovës për Siguri Publike, është institucion më rëndësi strategjike dhe rrejdhimisht disponon më sisteme të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, dhe së ka plotësuar së paku njërin nga kriteret e Rregullores (QRJ) nr.11/2023 për ekspertet, gjegjësisht kriteret e përcaktuar në nenin 3 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1.2 dhe nenit 4 paragrafi 3. Shtojnë së AKSP-ja sipas ligjit për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike është institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike, duke ofruar shërbime për institucionet e sigurisë publike si Policinë e Kosovës, Shërbimin Korrektues, Shërbimin Sprovues, Doganën e Kosovës, Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave, Inspektoratin Policor të Kosovës, shërbime këto që nuk mund të realizohen pa sistemet më të cilat operon Divizion i IT-së. Theksojnë së AKSP-ja ka nëntë (9) sisteme të TIK më rëndësi strategjike për funksionimin e AKSP-së si: 1. Sistemi për Menaxhimin e Trajnimeve (Baza e të dhënave të AKSP); 2. Sistemi i Mësimin në distancë E-learning (MOODLE); 3. Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU), për Fakultetin e Sigurisë Publike; 4. Rrjetat Kompjuterike. Sistemi Telefonisë (VOIP) ASTERISK); 7. Sistemi Digjital për Menaxhimin e Bibliotekës; 8. Sistemi i Vëzhgimit të ASKP-së me IP Kamera dhe Sistemi i Pajisjeve të kontrollit të Qasjes; dhe 9. Sistemi i Sigurisë përmes Two Factor Authentication apo qasjes me Smarta Kartela. Kërkojnë që Këshilli të aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e ankuesit, të ndryshohet vendimi nr.23/165 i datës 12.10.2023 i Qeverisë së Kosovës, duke përfshirë sistemet e informacionit dhe komunikimit të AKSP-së në listën e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimeve më rëndësi strategjike si dhe duke përfshirë ankuesit si zyrtarë të IT-së në AKSP-së në listën për ekspertë sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L196 për Pagat në Sektorin Publik.

Në kuptim të shqyrtim të pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 11/2023 për Ekspertë, më të cilën janë përcaktuar rregullat dhe procedura për zbatim të shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. me theks të veçantë:

- **Nenin 3**, më të cilin është përcaktuar se: 1. *Shprehjet e përdorura kanë këtë kuptim: 1.1. sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike - nënkupton sistemet që plotësojnë së paku njërin nga kriteret në vijim: 1.1.1. infrastruktura kritike e informacionit (IKI), që përfshinë sistemet ose funksionet, paaftësimi ose shkatërrimi i të cilave do të mund të cenonte sigurinë kombëtare, qeverisjen, ekonominë ose mirëqenien sociale të vendit; 1.1.2. sistemet përmes të cilave qeveria realizon funksionet e saj themelore (sistemet e tatimeve, doganave, thesarit, buxhetit, prokurimit publik, shëndetësisë, mirëqenies sociale, arsimit, sigurisë, gjykatave, prokurorisë, sigurisë kibernetike, mbrojtjes, etj); 1.1.3. regjistrat kyç shtetëror (regjistri civil, regjistrat kadastral, regjistri i bizneseve, regjistri i OJQ-ve, regjistri i lëndëve gjyqësore, regjistri i adresave, regjistri i automjeteve, etj.); 1.1.4. sistemet të cilat lidhen me menaxhimin e proceseve në administratën publike (sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore; sistemin për menaxhimin e financave, sistemi i postës elektronike zyrtare shtetërore, sistemi për menaxhimin e pasurisë shtetërore, etj.). 1.1.5. sistemet qendrore të Qeverisjes (Platforma e interoperabilitetit, Portali qendror për shërbime ndaj qytetarëve dhe bizneseve, Sistemi i identifikimit dhe nënshkrimit elektronik); 1.1.6. qendrat shtetërore të të dhënave; 1.1.7. rrjeti qeveritar; 1.1.8. sistemet e sigurisë që mundësojnë sigurinë kibernetike, sigurinë e rrjetit qeveritar, të dhënave dhe të qasjes në sisteme kompjuterike* 1.1.3. regjistrat kyç shtetëror (regjistri civil, regjistrat kadastral, regjistri i bizneseve, regjistri i OJQ-ve, regjistri i lëndëve gjyqësore, regjistri i adresave, regjistri i automjeteve, etj.); 1.1.4. sistemet të cilat lidhen me menaxhimin e proceseve në administratën publike (sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore; sistemin për menaxhimin e financave, sistemi i postës elektronike zyrtare shtetërore, sistemi për menaxhimin e pasurisë shtetërore, etj.). 1.1.5. sistemet qendrore të Qeverisjes (Platforma e interoperabilitetit, Portali qendror për shërbime ndaj qytetarëve dhe bizneseve, Sistemi i identifikimit dhe nënshkrimit elektronik); 1.1.6. qendrat shtetërore të të dhënave; 1.1.7. rrjeti qeveritar; 1.1.8. sistemet e sigurisë që mundësojnë sigurinë kibernetike, sigurinë e rrjetit qeveritar, të dhënave dhe të qasjes në sisteme kompjuterike.

- **Nenin 4:** *Institucioni i cili vlerëson se posedon, menaxhon ose koordinon funksionimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike e që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, duhet të bëjnë kërkesë tek Komisioni, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje. 2. Kërkesa e Institucionit për konsiderimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike shtetërore duhet të përmbajë: 2.1. informacionin për nivelin e klasifikimit të sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.2. kategorinë e shërbimeve që ofrojnë sistemet përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.3. përshkrimin e të dhënave që përmbajnë sistemet përkatëse; 2.4. ndikimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit në realizimin e objektivave të institucioneve shtetërore; 2.5. ndikimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit në realizimin e obligimeve ligjore të institucionet kërkuar dhe institucioneve tjera shtetërore; 2.6. ndikimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit në realizimin e shërbimeve esenciale siç janë: shërbimet publike, shëndetësia, siguria, drejtësia, arsimit dhe mbrojtja; 2.7. rrezikun për sisteme përkatëse të rrjetit dhe informacionit nga sulmet kibernetike të brendshme apo të jashtme; 2.8. funksionet menaxhuese/koordinuese dhe shkallën e njohurive të specializuara që kërkohen për menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe avansimin e sistemeve përkatëse të rrjetit dhe informacionit; 2.9. periudhën kohore të përcaktuar që sistemet përkatëse të rrjetit dhe informacionit mund të mbeten jashtë funksionit; 2.10. sa është unik në nivel shtetëror secili*

sistemi përkatës i rrjetit dhe informacionit dhe a ofrohen shërbime të ngjashme edhe nga sisteme të tjera të rrjetit dhe informacionit nga institucione tjera shtetërore; 2.11. përshkrimin e informacioneve të tjera të rëndësishme për sistemet përkatëse të rrjetit dhe informacionit që nuk janë përshkruar më lartë dhe që e bëjnë të nevojshme vlerësimin e këtyre sistemeve të rrjetit dhe informacionit si sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike shtetërore; 12. datën e futjes në funksion të sistemeve përkatëse të informacionit dhe komunikimit; 2.13. emërtimin e pozitive kyçe që janë përgjegjëse për dizajnimin, menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemet përkatëse të informacionit dhe komunikimit, dhe propozimin për kategorizim të tyre sipas klasave të përcaktuara në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. 3. Kategorizimi i sistemeve në bazë të shërbimeve që ofron sipas paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të këtij neni ndahet si më poshtë: 3.1. shërbime për qytetarë 3.2. shërbimet për shëndetësi; 3.3. shërbime për financa / prokurim; 3.4. shërbime për siguri dhe mbrojtje; 3.5. shërbime për arsim; 3.6. shërbime për drejtësi; 3.7. shërbime interne për administratë publike. 4. Kërkesa e aprovuar nga Zyrtari më i lartë administrativ i institucionit, dërgohet tek komisioni qeveritar për vlerësim të sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike.

-Nenin 5: Kriteret për caktimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike. Sistemet do të vlerësohen si sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike nëse plotësojnë të paktën një prej kriterëve të përcaktuara në përkufizimin :e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike në paragrafin 1.1 të nenit 3 të kësaj Rregulloreje....”

Po ashtu për vendosje të drejtë lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji iu referua Ligjit Nr. 04/L-053 Për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, përkatësisht nenit 2 më të cilin është përcaktuar se : “ **Akademia e Kosovës për Siguri Publike (në tekstin e mëtejme Akademia) është institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.** 2.Akademia ofron shërbimet nga paragrafi 1. i këtij neni për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në: 2.1. Policinë e Kosovës; 2.2. Shërbimin Korrektues; 2.3. Shërbimin Sprovues; 2.4. Doganën e Kosovës; 2.5. Agjencinë e Menaxhimit Emergjent; 2.6. Inspektoratin Policor të Kosovës....”, rrjedhimisht, nga analizimi i bazës ligjore dhe bazuar në vlerësimin e shkresave të lëndës, Kolegji konstaton se Agjencia e Kosovës për Siguri Publike është institucion publik përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike. AKSP-ja ofron trajnime dhe arsim të lartë për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar si Policinë e Kosovës (PK), Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK), Shërbimin Sprovues të Kosovës (SHSK), Doganën e Kosovës (DK), Agjencinë e Menaxhimit Emergjent (AME) dhe Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK). Edukimi i pjesëtarëve të institucioneve të sigurisë publike është një ndër komponentët kyçe të zhvillimit dhe të krijimit të një sistemi modern dhe të qëndrueshëm të sigurisë në Kosovë. Në kuadër të ASK funksionon edhe Fakulteti i Sigurisë Publike i themeluar me Rregulloren Nr.05/2019 për Arsimin e Lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, i cili zhvillon programe të arsimit të lartë, hulumtimit dhe zhvillimit në fushën e sigurisë publike. Andaj, për realizimin e këtyre funksioneve dhe objektivave, Akademia e Kosovës për Siguri Publike posedon nëntë (9) sisteme të informacionit dhe komunikimit përmes të cilave menaxhohen, administrohet dhe ruhen të dhëna lidhur me pjesëmarrësit e trajnimeve dhe studentet, përfshirë të dhënat personale, provimet, kreditet, vlerësimet, certifikimet, regjistrimin dhe çregjistrimin e pjesëmarrëseve/studenteve, publikimin e rezultateve, administrimi dhe ruajtja e të dhëna për stafin e AKSP-së etj.

Andaj, nisur nga faktet si me lartë, Kolegji vlerëson së sistemet e TIK-ut, më të cilat menaxhon Akademia e Kosovës për Siguri Publike plotësojnë kushtet e sistemit të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike përkatësisht kriterin e përcaktuar me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2 ndërlidhur me nenin 4 paragrafi 3 nën paragrafi 3. 5 të Rregullores (QRK) nr.11/2023 për Ekspertët, ku përcaktohet se: *1.1.2. sistemet përmes të cilave qeveria realizon funksionet e saj themelore (sistemet e tatimeve, doganave, thesarit, buxhetit, prokurimit publik, shëndetësisë, mirëqenies sociale, arsimit, sigurisë, gjykatave, prokurorisë, sigurisë kibernetike, mbrojtjes, etj); 3.5 Kategorizimi i sistemeve në bazë të shërbimeve që ofron sipas paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të këtij neni ndahet si më poshtë: 3.5. shërbime për arsim;* kështu që, mbi këtë bazë rrjedhë së Komisioni gjegjes i themeluar sipas Vendimit nr.07/132 të datës 08.03.2023 të Qeverisë së Kosovës, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktik dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material, me rastin e mos kualifikimit të sistemit të TIK-ut të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, si sistem shtetëror i informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike në fushën e sigurisë dhe arsimit.

Për me tepër, Kolegji nga analizimi i Raportit të punës të komisionit gjegjes, ka gjetur se i njëjti në listën e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, ka përfshirë edhe sistemin i TIK-ut të Universitetit të Prishtinës, si institucion publik me funksion përkatësisht me ofrim të shërbimeve të njëjta sikurse Fakulteti i Sigurisë Publike në kuadër të AKSP-së, veprim ky qe sjellë rrethana të diskriminimit të institucioneve që ofrojnë shërbime të njëjta apo të ngjashme, kështu që, nisur nga këto fakte dhe rrethana rezulton së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesve.


Referuar konstatimit se sistemi i informacionit dhe komunikimit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, vlerësohet si sistem shtetëror i informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike mbi bazën e fakteve dhe arsyeve të theksuar më lartë, Kolegji vlerëson se edhe kategorizimi i pozitave të stafit të Divizionit të IT-së së AKSP-së duhet të behët në pajtim me shtojcën numër 14.4 të Ligjit NR. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që të aprovoj si të bazuar ankesën e ankuesve, duke obliguar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të kualifikoj në kuadër të listës së sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimeve me rëndësi strategjike, edhe sistemin e teknologjisë informative dhe të komunikimit të menaxhuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe së ankuesit si në pikën I të dispozitivit, të përfshihen në listën e eksperteve dhe atë ankuesi , në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit të Teknologjisë Informative, Ekspert 3, Klasa B3; ankuesi në pozitën e punës Administrator i bazave së të dhënave dhe sistemeve, Ekspert 6, Klasa B6, ndërsa, ankuesit dhe i në pozitën e punës Zyrtar i IT-së/ekspert i Teknologjisë Informative, të cilët sipas përshkrimit të detyrave të punës kanë funksione mbështetëse dhe të përkrahjes, duhet të kategorizohen në Ekspert 7, Klasa B7.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje*

Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.
Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1364/2023

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit _____, përfaqësuesi i përbashkët i ankuesve;
- Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike/Qeveria e Kosovës;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.